DEUTSCH COLOR

# IZODICHT ENERGIE D-17




## PERSHKRIMI

Material impermeabilizues i cilësisë premium me veti izoluese termike që ofron mbrojtje maksimale nga lagështia.

## KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

- Ngjitje e fortë
- Ngjyrë e bardhë
- Elastike edhe nën -20°C
- Qëndrueshmëri afatgjatë
- Punueshmëri e shumë e mirë
- Rezistencë të lartë ndaj ujit dhe temperaturave të larta dhe acarit

## PËRDORIME TË REKOMANDUARA

Izodicht Energy D-17 përdoret si hidroizolues nëpër tarraca, ballkone, mure, si edhe në vende me lagështi. Aplikohet lehtësisht duke krijuar një membranë hidroizoluese me elasticitet të lartë dhe rezistencë mekanike pa krijuar çarje ose tkurrje. Gjithashtu, është lehtësisht i aplikueshëm në zonat e vështira si kënde, bashkime të materialeve të ndryshme që formojnë fuga etj. Izodicht Energy D-17 nuk rekomandohet të përdoret për hidroizolimin e bodrumeve nëntokësore.

## KARAKTERISTIKA TEKNIKE

| | |
|---|---|
| Baza: | Acrylic copolymer |
| Densiteti EN ISO 2811- 1: | 1,35±0,02 gr/ml |
| Mbetja e thatë EN ISO 3251: | 50% |
| Raporti i përzierjes: | Gati për përdorim |
| Ngjyra: | E bardhë |
| Forca ngjitëse në beton: | ≥ 0.8 N/mm$^2$ |
| Konsumi: | 1Kg/m$^2$ |
| Koha e tharjes mes dy shtresave: | 4 – 6 orë |
| Koha e tharjes e plotë: | 24 orë |

## INSTRUKSIONE APLIKIMI

Sipërfaqet duhet të jenë plotësisht të thata, të pastra dhe pa pluhur dhe elementë që pengojnë ngjitjen e produktit.

## PREGATITJE E PRODUKTIT

Produkti është i gatshëm për aplikim, nuk rekomandohet hollimi i tij.

## APLIKIM I PRODUKTIT

Aplikohet në dy shtresa me furçë ose me rrul, mbasi të jetë tharë plotësisht astari i aplikuar paraprakisht mbi sipërfaqen që do të hidroizolohet. Konsumi është afërsisht 0.8 - 1kg/ m2 në varësi të sipërfaqes që do të hidroizolohet. Dora e parë duhet të aplikohet vetëm pasi astari të jetë tharë plotësisht, duhet ti kushtohet kujdes që aplikimi i dorës së dytë të bëhet në formë kryq mbi dorën e parë. Në zonat që karakterizohen nga plasaritje apo çarje rekomandohet që hidroizoluesi të përforcohet nga aplikimi i rrjetës me fibra xhami me një dendësi prej 65 - 125 gr, e cila aplikohet menjëhere mbas aplikimit të dorës së parë të hidroizoluesit. Më pas mbi rrjetën aplikohen nga një deri në dy shtresa të tjera me hidroizolues. Në rastet kur sipërfaqja që do të hidroizolohet karakterizohet nga çarje dhe plasaritje të shpeshta rekomandohet që rrjeta me fibra xhami të aplikohet në të gjithë sipërfaqen që do të hidroizolohet. Në këtë rast konsumi i Izodicht Energy D-17 shkon në 1.5 - 2 Kg/m2. Duhet pasur kujdes që rrjeta e vendosur mbi sipërfaqen që do të hidroizolohet nuk duhet të krijojë tkurrje por të jetë e tendosur mirë mbi sipërfaqe. Pastroni spatulat dhe mjetet e tjera të punës me ujë menjëherë pas aplikimit.

## PAKETIMI

5Kg / 20Kg plastic buckets

## KONSUMI

0.8 - 1 lt/m$^2$

## RUAJTJE

24 muaj nëse ruhet në një vend të thatë, larg burimeve të nxehtësisë, në një temperaturë midis +5°C dhe +30°C. Mbrojeni nga ngrica.

## HEALTH AND SAFETY INFORMATION

Keep out of reach of children. In case of contact with the eyes or swallowing, please seek medical advise immediately and show the contents of the container. Do not dispose the product into drains.